



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 255 Prot

Datë ____ .06.2026

Njoftim per konsultim publik

Këshilli i Bashkisë Elbasan

Titulli: Mbledhja e rekomandimeve per prioritetet e komunitetit per projekt Buxhetin 2027, dhe per Paketën Fiskale 2027.

Propozuesi: Projekt aktet jane propozuar nga Ekzekutivi/Kryetari i Bashkise, Z. Gledian Llatja

Kalendari i konsultimit: Konsultimi publik do te realizohet në datat si më poshtë:

Nr.	BASHKIA ELBASAN	LAGJA/NJËSIA ADMINISTRATIVE	ORA	DATA	VENDI I TAKIMIT
1	Elbasan	Shushicë	10:00	05.10.2026	Pranë Njesisë Administrative
2	Elbasan	Shirgjan	12:30	05.10.2026	Pranë Njesisë Administrative
3	Elbasan	Rajoni 2	17:00	05.10.2026	Onufri
4	Elbasan	Gjergjan	10:00	06.10.2026	Pranë njesisë administrative
5	Elbasan	Rajoni 3	17:00	06.10.2026	Shkolla "Jorgji Dilo"
6	Elbasan	Rajoni 6	18:30	06.10.2026	Shkolla "Qemal Haxhihasani"
7	Elbasan	Papër	11:00	07.10.2026	Pranë Njesisë Administrative
8	Elbasan	Rajoni 5	17:30	07.10.2026	Shkolla "Fadil Gurmani"
9	Elbasan	Gjinar	10:00	08.10.2026	Pranë Njesisë Administrative
10	Elbasan	Tregan	13:00	08.10.2026	Shkolla "Jonuz Carciu"
11	Elbasan	Bradashesh	18:00	08.10.2026	Pranë Njesisë Administrative
12	Elbasan	Labinot Mal	10:00	09.10.2026	Pranë Lagjes
13	Elbasan	Labinot Fushë	12:30	09.10.2026	Pranë Njesisë Administrative



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK**

14	Elbasan	Gracen	17:30	09.10.2026	Pranë Njesisë Administrative
15	Elbasan	Funar	10:00	12.10.2026	Tek lokali, nenkalimi ne Dopaj
16	Elbasan	Rajoni 1	17:30	12.10.2026	Shkolla "Ligj Gurakuqi"
	Elbasan	Zavalinë	11:00	13.10.2026	Pranë njësisë administrative
	Elbasan	Rajoni 4	17:30	13.10.2026	Shkolla Bardhyl
					Popa
17	Elbasan	Klubi Shumësportësh	10:00	19.10.2026	Pallati i Sportit
18	Elbasan	Rinia	12:00	19.10.2026	Parku Rinia
19	Elbasan	Af Elbasani	14:00	20.10.2026	Sporti i Vjetër
20	Elbasan	Biznesi	11:00	21.10.2026	Salla Multifunkionale

Pjesëmarrës:

- **Nga ana e Bashkisë dhe e këshillit bashkiak:** Anëtarët e Keshillit Bashkiak, Përfaqësues nga ekzekutivi , Anëtarët e Komisionit të Ekonomisë dhe Financës të Këshillit të Bashkisë, Kryetarja e Aleancës së Grave Këshilltare, Koordinatori për Njoftimin dhe Konsultimin Publik, Zyra e Financës së Bashkisë,
- **Nga komuniteti:** Banorët e qytetit të Elbasanit, banorë dhe përfaqësues nga NJA, kryetarët e fshatrave, përfaqësues nga institucionet, përfaqësues nga biznesi, përfaqësues nga grupe të marginalizuara, OJF, etj

-Forma e konsultimit:Takim publik

Qëllimi i këshillimit publik	1. Evidentimi i nevojave të komunitetit për përmirësimin e shërbimeve publike.
------------------------------	--



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK**

Përshkrimi i çështjeve që trajton projekt buxheti afatmesëm	Miratimi i projekt buxhetit është një vendim i rëndësishëm që merret nga Këshilli i Bashkisë, pasi përcakton fondet që do të përdoren për të gjitha shërbimet / funksionet e ushtruara nga Bashkia dhe performancën e tyre. Këshilli i Bashkisë duhet të sigurohet që fondet publike shkojnë për përmirësimin e shërbimeve që ofrohen nga Bashkia për komunitetin dhe adresojnë nevojat e tyre, brenda kapaciteteve financuese të Bashkisë.
Pyetjet që ngre Këshilli ndaj publikut	Këshilli i Bashkisë është i interesuar të marrë opinionin e komunitetit në lidhje me çështjet si vijon : 1. A jeni dakort me mënyrën si janë shpenzuar paratë? 2. Cilat jane nevojat tuaja per te cilat duhen permiresuar sherbimet nga ana e Bashkise? 3. Për cilin shërbim publik jeni më të kënaqur? 4. Tjetër
Shpjegim të procesit që do ndjekë dhe veprimet që do të ndërmarrë Këshilli për të shqyrtuar rekomandimet nga publiku deri në marrjen e vendimit	Pas mbledhjes së rekomandimeve, Këshilli i Bashkisë do të ndjekë hapat si vijon: 1. Realizimin nga ana e Sekretariatit të Këshillit i një Përmbledhje të Rekomandimeve dhe rezultateve të plota të takimit që përfshin të gjitha mendimet dhe propozimet që do të vijnë nga komuniteti dhe bërja publike e kësaj Përmbledhje; 2. Dërgimi i kësaj Përmbledhje Rekomandimesh Kryetarit të Bashkisë, Komisionit të Ekonomisë dhe Financës, taksave dhe tarifave dhe çdo këshilltari të bashkisë; 3. Shqyrtimi nga ana e komisionit të ekonomisë dhe financës, taksave dhe tarifave (mbledhja e komisionit është e hapur për



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK**

	publikun sipas datave të parashikuara në kalendar) të cdo rekomandimi dhe të opinionit të Kryetarit të Bashkisë; 4. Marrja e vendimit për rekomandimet që do të përfshihen në projekt 5. t buxhetin vjetor. Vendimi i bashkëngjitet dokumentit të projekt buxhetit afatmesëm dhe projekt buxhetit vjetor; 6. Diskutimi dhe miratimi i aktit në seancën e hapur të Mbledhjes së Këshillit; 7. Informimi i komunitetit, për marrjen në konsideratë të rekomandimeve ose për mosmarrjen në konsideratë dhe arsyet e mosmarrjes në konsideratë të tyre; 8. Publikimi i aktit në faqen e Këshillit të Bashkisë dhe në tabelat e informimit; 9. Njoftimi i administratës për aktin e miratuar; 10. Monitorimi i zbatimit të tij.
Ndryshimet kryesore dhe/ose alternativat e mundshme	Opsionet e mundshme janë për t'u shqyrtuar nga ana e Këshillit tone : Ndryshime në alokimin e fondeve për programe të caktuara me qëllim përmirësimin e shërbimeve të ofruara nga Bashkia.
Kontaktet dhe afatet e degimit të komenteve, rekomandimeve, verejtjeve	Sugjerimet janë të mirëpritura në adresën e email: albpapa87@gmail.com
Data e publikimit	____.09.2026

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

LUTFILALA